




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

V E N D I M

Nr. 224 Prot

Shkodër me 21.03 2026

Nr. 07, Datë 27 . 03 .2026

“MBI MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMEVE DHE PARASHIKIMEVE AFATMESME TË TË ARDHURAVE DHE TAVANET PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 NË NIVEL PROGRAMI”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 27 . 03 .2026, pasi dëgjoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër **“Mbi miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të Ardhurave dhe Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 në nivel programi”**, bazuar në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015” Për Vetëqeverisjen vendore”, në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nenin 34 të ligjit nr. 68/2017” Për Financat e vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimit Nr.7, datë 27.02.2026” Për përgatitjen e Programit buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029”, Bazuar edhe në Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relatimit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **14 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim,**

V E N D O S I;

1. Të miratojë **Raportin për Vlerësimet dhe Parashikimet Afatmesme të të Ardhurave të Këshillit të Qarkut Shkodër** për;
 - a) Dy vitet para vitit buxhetor,
 - b) Vitin buxhetor,
 - c) Tre vitet e ardhshme buxhetore,
2. Të miratojë Tavanet Përgatitore të shpenzimeve të **Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029**, për Këshillin e Qarkut Shkodër sipas pasqyrave bashkangjitur.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.



KRYETARI

Edmond NDOU

Tavanet e PBA - 2027-2029

Planifikimi i Shpenzimeve të Programit		2026-2028		TAVANET			
2027-2029		Tavanet e PBA për institucionin dhe Tavanet e Programit					
Emri i Entit:		KESHILLI I QARKUT SHKODER					
Numri i Grupit:							
		Mije Lekë					
Tavani i Institucionit				Buxheti		PBA 2027-2029	
		Emri i Artikullit	Nr. i Artikullit	2026	2027	2028	2029
TOTALI	Paga	600-601		43,418.0	32,700.0	32,700.0	32,700.0
	Korente të tjera	602-606		53,527.0	18,000.0	18,000.0	18,000.0
	Kapitale	230-231		55,813.0	37,897.0	39,832.0	43,424.0
	Jashtë-buxhetore			9,365.0	2,278.0	0.0	0.0
	Totali			162,123.0	90,875.0	90,532.0	94,124.0
Alokimi i Tavanit për Programet							
Emertimi i Programit		Emri i Artikullit	Nr. i Artikullit	Buxheti		PBA 2027-2029	
				2026	2027	2028	2029
Planif.menaxh.administrim	Paga	600-601		34,126.0	32,700.0	32,700.0	32,700.0
	Korente të tjera	602-606		27,183.0	18,000.0	18,000.0	18,000.0
	Kapitale	230-231		55,813.0	37,897.0	39,832.0	43,424.0
	Jashtë-buxhetore			9,365.0	2,278.0	0.0	0.0
	Totali			126,487.0	90,875.0	90,532.0	94,124.0
Nr. Titullit Programor							
AA033							
Alokimi i Tavanit për Programet							
Emertimi i Programit		Emri i Artikullit	Nr. i Artikullit	Buxheti		PBA 2027-2029	
				2026	2027	2028	2029
Planif.menaxh.administrim	Paga	600-601		9,292.0			
	Korente të tjera	602-606		290.0			
	Kapitale	230-231					
	Jashtë-buxhetore						
	Totali			9,582.0	0.0	0.0	0.0
Nr. Titullit Programor							
01160,DAMT							
Alokimi i Tavanit për Programet							
Emertimi i Programit		Emri i Artikullit	Nr. i Artikullit	Buxheti		PBA 2027-2029	
				2026	2027	2028	2029
Ministria e Shëndetsise	Paga	600-601					
	Korente të tjera	602-606		26,054.0	0.0	0.0	0.0
	Kapitale	230-231					
	Jashtë-buxhetore						
	Totali			26,054.0	0.0	0.0	0.0
Nr. Titullit Programor							
10430							
Miratimi		Nepunesi Zbatues		Nepunesi Autorizues			
		Emri:		Emri:			
		Nënshkrimi:		Nënshkrimi:			
		Data:		Data:			

KESHILLI QARKUT SHKODER

RAPORTI PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE


000/leke

Nr	Emertimi i të Ardhurave Tatimore	Fakti per vitin 2024	Fakti per vitin 2025	2,026	Buxheti per vitin 2027	Buxheti per vitin 2028	Buxheti per vitin 2029
A	Të ardhura						
I	Të ardhura nga tarifat	94	516	615	200	200	200
a	Tarifa për konfirmim hartash	22	22	50	50	50	50
b	Tarifa për shërbime administrative(dok. Arshivore)	25	23	50	50	50	50
c	Tarifa sherbim Kadastral	47	57	70	70	70	70
d	Teardhura te tjera gjoba e penalitete	0	0	30	30	30	30
f	Teardhura te tjera nga proj me fh	0	414	415	0	0	0
II	Të ardhura te ndryshme	1,940	1,940	1,940	1,940	1,940	1,940
a	Te ardhurat nga kuota vjetore e bashkive	1,940	1,940	1,940	1,940	1,940	1,940
A	Totali i te ardhurave te veta (I+II)	2,034	2,456	2,555	2,140	2,140	2,140
B	Transferta e pakushtezuar	60,592	69,339	77,613	79,383	81,318	84,910
B1	Transferta e pakushtezuar sektoriale	2,887	6,500	7,074	7,074	7,074	7,074
	Shuma B	63,479	75,839	84,687	86,457	88,392	91,984
E	Te trasheguara	103	3,644	30,489	0	0	0
C	Transferta e kushtezuar DAMT	7,820	8,360	9,582			
C1	Transferta e kushtezuar MSHCS+MK	19,282	22,608	26,054	0	0	0
C2	Transferta e kushtezuar AKUM	43,599	0	0	0	0	0
D	Financime te huaja	0	1,203	8,756	2,278	0	0
	ADRIATICAVES (Thesari)				0	0	0
	SMARTMOBAIR		1,203	8,756	2,278	0	0
	Totali I te ardhurave	136,317	114,110	162,123	90,875	90,532	94,124

Nëpunësi Zbatues

Gjyljana MIRUKU

KRYETARI
Edmond Ndoe





REPUBLIKA E SHQIPERISË
KESHILLI QARKUT SHKODËR
Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Shkodër me 31.03 2026

RELACION

“Mbi miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të Ardhurave dhe Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 në nivel programi”

Në zbatim të nenit 34 të ligjit 68/2017 “ Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimit Nr.7, datë 27.02.2026 ”Për përgatitjen e Programit buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029”, bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe në vlerësimet afatmesme të transfertave, kemi përgatitur dhe po paraqesim për miratim analizën dhe vlerësimin e të ardhurave dhe tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 .

I-Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të Ardhurave për;

1. Vitin buxhetor 2026,
2. Dy vitet para vitit buxhetor dhe konkretisht fakti i vitit 2024 dhe 2025, pasqyruar në tabelën bashkangjitur.
3. Për tre vitet e ardhshme buxhetore dhe konkretisht për vitet 2027 dhe 2028 dhe për vitin 2029 janë përcaktuar tavanet duke u nisur nga vlera absolute e miratuar në udhëzimin e lartpërmendur për shumën e transfertës së pakushtëzura për vitet respektive buxhetore dhe të ardhurat e vendosura duke ruajtur raportin e viteve 2027-2029.

a) Metodologjia e përdorur për parashikimet e të ardhurave

Duke u nisur nga kuadri ligjor të ardhurat që Këshillat e Qarqeve mund të arkëtojnë, janë tarifat për shërbimet që kryhen për konfirmime hartash, nxjerrje dokumentash arshivore, gjoba e penalitete dhe tarifa për shërbime të kryera nga funksioni i deleguar DAMT. Këto janë burimet e vetme ligjore për tarifata e shërbimeve që qarqet mund të krijojnë të ardhura.

Parashikimet e këtyre të ardhurave janë berë bazuar në të ardhurat faktike të vitit të fundit kalendarik, të cilat janë ulur në mënyrë të ndjeshme dhe në krijimin e mundësive për rritjen e tyre, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

Kuadri Makroekonomik e fiskal për periudhën 2027-2029,i miratuar me VKM për Këshillat e Qarqeve, si njësi e nivelit të dytë të qeverisjes vendore,është shumë i kufizuar, pothuajse i paperfillshem.

Kuotat e antarësisë së bashkive përbërëse të Qarkut Shkodër, megjithëse zenë pjesën më të madhe të të ardhurave totale të KQSh, meqënëse vendoset nga bashkitë me vendim të Këshillit Bashkiak, kjo kuotë është vendosur duke parë tendencën e viteve të fundit dhe të ardhurat faktike nga kuota e

anëtarësisë. Megjithëse kjo kuote planifikohet ne buxhetet e bashkive, nuk mblidhen të ardhura nga bashkite dhe si pasojë nuk bëhen veprimet ekonomike për transferimin e saj në buxhetin e KQSH.

Sic shihet ne tabelen që përmban të dhënat për parashikimet afatmesme të të ardhurave, në vitin 2024, fakti i të ardhurave nga kuota e antarësisë ka qenë 1,940 mijë lekë ndersa në vitin 2025 fakti i të ardhurave nga kuota e antarësisë ka qenë 1,940 mijë lekë.

Planifikimi i kuotës së antarësisë nga bashkitë e qarkut Shkodër , për vitin 2024 eshte në masën 1,940 mijë lëke dhe është realizuar në masën 1,940 mijë lekë ose në masën 100% dhe për vitin 2025 është planifikuar në masën 1,940 mijë lekë dhe është realizuar në masën 1,940 mijë lekë ose 100%.

Planifikimi i kuotës së antarësisë nga bashkitë e qarkut Shkodër, për vitet 2027-2029, është bërë bazuar në planifikimin që është bërë ne dy vitet paraardhëse si dhe në faktin e realizuar për këto dy vite .

Planifikimi i ketyre të ardhurave nga tarifat eshte bërë edhe per tre vitet e ardhshme duke u bazuar afërsisht ne planin dhe në faktin e vitit 2025.

Paraqitja e planifikimit te te ardhurave per tre vitet e ardhshme buxhetore 2027-2029, paraqitet ne tabelen e mëposhtme;

Nr.	Emertimi i te ardhurave	Të Ardhurat		
		Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
1	Kuota e antaresise	1,940	1,940	1,940
2	Te ardh. Nga DAMT	70	70	70
3	Te Ardh nga konfirmime hartash	50	50	50
4	Te Ardh nga nxjerrje doc arshiv.	50	50	50
5	Te ardhura nga penalitete gjoba	30	30	30
	Totali	2,140	2,140	2,140

b) Analiza e efekteve të politikave fiskale .

Këshilli i Qarkut shkodër, bazuar në llojin e të ardhurave që mund të arkëtojnë siç janë tarifat për shërbimet që kryhen për konfirmime hartash, nxjerrje dokumentash arshivore dhe tarifa për shërbime të kryera nga funksioni i deleguar DAMT apo dhe gjoba dhe penalitete, politikat e reja fiskale, nuk kanë dhënë efekt tek tarifat e planifikuara te të ardhurave, pasi këto të ardhura lidhen me lëshime dokumente ardhivore , te cilat si rezultat i ndryshimeve ligjore, janë gjithnje e më pak të kerkuara.

Në tabelën PERMBLEDHESE E TE ARDHURAVE, paraqiten te ardhurat e planifikuara sipas llojit te tyre për vitin buxhetor, faktin e të ardhurave për dy vitet e mëparshme buxhetore si dhe per 3 vitet e ardhshme buxhetore, 2027-2029.

c) Analiza e rrisqeve dhe masat për përballimin e tyre.

Nisur nga kuadri ligjor i të ardhurave, KQShkodër bën planifikimin e tyre në mënyrë të tillë që të mos ketë efekt negativ në përmbushjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të cilat janë të sanksionuara në ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”

Pesha specifike e të ardhurave të planifikuara dhe të realizuara në raport me të ardhurat totale nga burimet e tjera për KQShkodër është shumë e vogël.

Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të miratuara si dhe në transfertat e pakushtëzuara të përcaktuara në vlerë absolute në Udhëzimin nr.8, date 28.02.2025 të Ministrisë së Financave, janë përgatitur dhe i paraqesim për miratim tavanet përgatitore të shpenzimeve për PBA-në 2026-2028 në nivel programi të cilat do të shërbejnë për përgatitjen e PBA-së 2026-2028 në vazhdim sipas afateve të përcaktuara ligjore.

II-Tavanet Përgatitore të PBA-së 2027-2029

Bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, date 27.02.2026 “Për përgatitjen e Programit buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029”, në Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor, Këshilli i Qarkut Shkodër do ketë 1 program edhe për tre vitet e ardhshme buxhetore 2027-2029, e paraqesim Planifikimin e Shpenzimeve në një program buxhetor.

Si rezultat i kësaj Tavanet përgatitore janë pasqyruar në programin AA033 por brenda këtij programi do të bëhet ndarja sipas produkteve, llojeve të shpenzimeve .

Për Përgatitjen Tavanëve Buxhetore 2027-2029 është marrë parasysh shuma e planifikuar për KQShkodër nga **Transferta e Pakushtëzuar** si dhe të **ardhurat** që do të planifikohen për tre vitet e ardhshme buxhetore, sipas tabelës së mësipërme, bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme

- Per viti 2026 **Transferta e Pakushtëzuar** është 77,613 mijë lekë dhe **Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale për rritjen e nivelit të pagave** është 7074 mijë lekë.

Totali i fondeve nga transferta e pakushtëzuar per vitin 2026 është 84,687 mijë lekë.

- Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve dhe taksa e Qarkut **2,555 mije lek**

- Fonde te trashëguara nga viti 2025 **30,489 mijë lekë;**

- Fonde te kufizuara për funksionin e deleguar DAMT **9,582 mijë lekë;**

- Fonde te kufizuara për fondin Social 2026 **26,054 mijë lekë;**

- Fonde me financim të huaj **8,756 mijë lekë** (fondet e vitit si dhe ato të trashëguara nga viti 2025)

Në Total të ardhurat për vitin 2026 162,123 mijë lekë.

- Per viti 2027 **Transferta e Pakushtëzuar** është 79,383 mijë lekë dhe **Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale për rritjen e nivelit të pagave** është 7,074 mijë lekë. Të ardhurat 2,140 mijë lekë. Fonde me financim të huaj 2,278 mijë lekë. Totali i fondeve per vitin 2027 është 90,875 mijë lekë.

- Per viti 2028 **Transferta e Pakushtëzuar** është 81,318 mijë lekë dhe **Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale për rritjen e nivelit të pagave** është 7,074 mijë lekë. Të ardhurat 2,140 mijë lekë. Totali i fondeve per vitin 2028 është 90,532 mijë lekë.

- Per viti 2029 Transferta e Pakushtëzuar është 84,910 mijë lekë dhe Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale për rritjen e nivelit të pagave është 7,074 mijë lekë. Të ardhurat 2,140 mijë lekë. Totali i fondeve per vitin 2029 është 94,124 mijë lekë.

Siç shihet nga tabela, për tre vitet e ardhshme, tavanet përgatitore janë të përfshira në një programi më poshtë;

1. *1-Programi Organet Ekzekutive dhe Legjislative (Planifikim, menaxhim, administrim).*
Programi AA033

1-Programi Organet Ekzekutive dhe Legjislative (Planifikim, menaxhim, administrim).
Progr.1a- Programi AA033

Programi AA033, përfshin planifikimin, menaxhimin e administrim për administratën e institucionit tone, per te mundesuar përgatitjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave sipas kuadrit ligjor ne fuqi siç jane shpenzimet per pagat dhe sigurimet shoqerore, shpenzime korrente ku përfshihet aktivitetet per kryerjen e funksioneve te qarkut, transferta te brëndshme dhe te jashtme bashkëfinancime me projekte me Financim të Huaj si dhe shpenzime per investime per vitet 2027-2029.

Në fazën e parë të PBA-së , propozojmë Deklaratën e Politikës së Programit e cila bazuar në aktet ligjore në fuqi përfshin;

- ✓ **Zhvillimin e Njesisë, menaxhimin financiar të fondeve buxhetore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimin e proceseve të brëndshme, komunikimi me publikun si dhe harmonizimi i politikave rajonale me ato shtetërore në nivel qarku.**
- ✓ **Shërbime në mbeshtetje të Kryetarit dhe të keshillit të vetëqeverisjes vendore, funksionimin dhe mirembajtjen e infrastruktures fizike permes shpenzimeve korrente dhe kapitale si dhe bashkërendimi institucional me njësitë e vetëqeverisjes vendore të qarkut Shkodër për kryerjen e investimeve bazuar në marrëveshjet mes tyre dhe në aktet ligjore.**
- ✓ **Zhvillimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme për rajonin, në kuadër të harmonizimit dhe strategjive vendore dhe rajonale, në përputhje me ato qëndrore, në fushën e turizmit, pjesëmarrjen në projekte të ndryshme ndërkombetare dhe bashkëfinancimi me keto projekte.**

Bazuar në Deklaratën dhe përshkrimin e programit(*Planifikim, menaxhim, administrim*).

Progr.1a- Programi AA033, qëllimin dhe objektivat e tij, planifikimi do të bëhet bazuar në produktet e programit, bazuar në sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor(SMBV).

Paraqesim për miratim P/Vendimin e mësipërm.

NËPUNËSI ZBATUES

Gjyljana MIRUKU

